

## GJURMIME NË PUBLICISTIKËN E SAMI FRASHËRIT

- Me rastin e 110-vjetorit të ndarjes nga jeta -

Sami Frashëri, i njohur në literaturën e përbotshme me emrin Shemesettin Sami Frashëri, lindi në Frashër të Përmetit më 1 qershor 1850. Në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare, familjarisht u vendos në Janinë. U regjistrua në gjimnazin Zosimea, ku u shqua për zell e dituri. Një vit pas diplomimit, më 1872, shkoi në Stamboll. I formuar, me kulturë të përgjithshme, me disa gjuhë: greqishten e vjetër, latinishten, frëngjishten, italishten, arabishten e persishten, me të arritur në Stamboll filloi punë në një zyrë botuese. U shqua në gazetari e publicistikë, në gjuhësi e filozofi, në studime e vepra në fushën e shkencave humane, të shumëvlerësuara në Turqi dhe në botë. Ndërkohë, iu përkushtua kauzës kombëtare deri në çastet e fundit të jetës. U nda nga jeta më 5 qershor 1904.

Në këtë shkrim bëhen përpjekje për të gjurmuar e skicuar veprimtarinë e tij publicistike, aq të begatë.

Dijetari i shquar, një nga ideologët e Rilindjes Kombëtare, Sami Frashëri, përpara se t'u hynte veprave madhore të kulturës osmane dhe turke,<sup>1</sup> ka ushtruar fletorizmin, si gazetar e drejtues (kryeredaktor e redaktor) i një vargu gazetash e revistash kulturore, shoqërore dhe politike. Në Stamboll, gjatë viteve 1872-1884, drejtoi e redaktoi 8 gazeta e revista, duke merituar vlerësim të çmuar në historiografinë e gazetarisë turke.

---

1 - Ka shkruar e botuar 57 libra, Ndër veprat madhore të tij shquhen fjalorët dhe enciklopeditë: Kamus-i Fransevi (1882-1905, fjalor frëngjisht-turqisht), Kamus-i Fransevi (1885, fjalor turqisht-frëngjisht), Kamus-ul Alam (6 vëllime, 1889-1898, enciklopedi e përgjithshme), Kamus-i Arabi (1898, fjalor arabisht-turqisht, i papërfunduar) dhe Kamus-i Turki (2 vëllime, 1899-1900).

1. Veprimtaria publicistike e Sami Frashërit zhvillohet në katër kohë. Kohështrirja e parë lidhet me emërimin e Samiut në Drejtorinë e Shtypit të Stambollit, "Matbuat Kalemi", më 1872, sapo kishte shkelur në Stamboll. Fillimisht mori përsipër drejtimin e revistës "Hadika" (Kopshti), të cilën, një vit më parë, e kishte themeluar Namik Kemali,<sup>2</sup> i sapokthyer në Turqi. Revista "Hadika" doli deri në numrin 72 në mars të vitit 1873. Më pas kaloi në të përkohshmen "Siraxh" ku punoi redaktor e përkthyes. Por edhe ajo shpejt u ndalua, më 6 prill 1873.

Ndërkohë, Samiu bashkohet me qarqet shqiptare, që zhvillonin veprimtari politike kombëtare, ku shquhet për idetë e tij përparimtare. Me këtë motivim e internojnë në Libi. Por edhe atje, me ndërmjetësinë e shkrimtarit Turk Sezai Efendi, valiu Sami Pasha i dha drejtimin e gazetës së përjavshme "Tarabullus garp" (Tripolis, 1874), organ i vilajetit. Botohej në dy gjuhë: arabisht dhe turqisht. Gjatë qëndrimit në Tripoli shkroi edhe dramën "Besa". Kjo periudhë e shkurtër përbën kohështrirjen e dytë të veprimtarisë gazetareske të Samiut. Më 1875, me interesimin e valiut të Tripolit, Samiu kthehet nga internimi. Ai e ndiente të nevojshme të merrej me gazetari, pasi ashtu kishte mundësi të shfaqte mendimet patriotike, kombëtare, përparimtare e demokratike.

Periudha e tretë shtrihet në vitet 1876-1877, që zë fill me revistën letrare "Muharrir" (Shkrimtari) dhe përmbillet me të përjavshmen "Aile" (Familja). Në muajt e parë të 1876-s, Sami Frashëri merr drejtimin e revistës "Muharrir" (Shkrimtari). Pasi botoi 4 numra të kësaj të përkohshmeje me ndikim në qarqet intelektuale, nis përgatitjet për themelimin e të së përditshmes "Sabah" (Mëngjesi), numri i parë i së cilës doli më 9 mars 1876. Samiu qe kryeredaktor, por bënte edhe punën e redaktorit. Editorialet e gazetës "Sabah", shkruar çdo ditë nga Samiu, mirëpritëshin. Problematika dhe këndvështrimi i çështjeve të trajtuara në fletore nuk u shkante për osh qarqeve zyrtare të Stambollit. Prandaj, duke u nisur nga një lajm, që binte ndesh me

---

2 - Namik Kemal (1840-1888) ishte një nga intelektualët e shquar otomanë, gazetar, publicist, dramaturg dhe veprimtar politik i lëvizjes së Turqëve të Rinj, për reformimin e Perandorisë Otomane. Emrin e tij sot e mban një nga universitetet më të njohura të Turqisë

orientimet e Portës së Lartë, qeveria e ndaloi botimin e gazetës. Me këtë rast, Samiu botoi një shkrim të ashpër në shtypin turk kundër censurës dhe për lirinë e shtypit. Gazeta "Sabah", siç shkruante turkologu i shquar Hasan Kalleshi, doli edhe tej numrit 256 të 5 janarit 1887. Atë vit, Samiu nxori revistën e përjavshme "Aile" (Familja), me tematikë sociale, kushtuar grave, punëve shtëpiake, rritjes dhe edukimit të fëmijëve.

E begatë, si nga angazhimi përkushtues i Samiut, organizator dhe drejtues, ashtu edhe publicist profesionist aktiv me ide, mendime dhe ndjenja kombëtare, është kohështrirja e katërt në vitet 1888-1891.

2. Në agun e promovimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Sami Frashëri merr drejtimin e të së përditshmes së Stambollit, "Tercuman-i Sark", e shqipëruar "Përkthyesi i Lindjes" numri i parë i së cilës kishte dalë në qarkullim më 22 mars 1878. Emri i Samiut si kryeredaktor i kësaj gazete shënohet nga numri 74 (10 prill 1878).<sup>3</sup> Kjo e përditshme u shndërrua në një tribunë të çështjes shqiptare. Thujse çdo ditë në 100 numrat e kësaj gazete, që Samiu nxori, botoi editorialin dhe një shkrim pa firmë. Në shumicën e tyre, duke shtruar probleme që lidheshin me kufijtë e Turqisë, mbronte me ngulm trojet etnike shqiptare. Ishte koha e Kongresit të Berlinit (1878), ku do të përcaktoheshin edhe kufijtë e Shqipërisë. Samiu mpreh penën, bashkëbisedon, dialogon, polemizon me gazeta e gazetarë, ashtu si edhe me historianë e politikanë, të cilët, për interesa shoviniste a koniunkturale, tentojnë të shtrembërojnë të vërtetat për Shqipërinë e kombin shqiptar.

Në "Tercuman-i Sark" u shqua kryesisht për shkrime me temë: kërkesat e të drejtave të Shqipërisë dhe të shqiptarëve. Për këtë qëllim shfrytëzonte editorialin, pasi ky zhanër ka karakter orientues, shpreh mendimin e qëndrimin e redaksisë për çështjen e shtruar apo të trajtuar. Mendime të guximshme në mbrojtje të çështjes kombëtare shqiptare dhe të kufijve të Shqipërisë vihen re sidomos në editorialet e numrave 75, 78, 85, 87, 104 e 106 të "Tercuman-i Sark". Në ta, Samiu i gërsheton problemet e

3 - Revista "Tribuna e gazetarit", Tiranë, 1971, nr. 2, fq. 48

Shqipërisë, kur trajton çështjen e Lindjes apo komenton ngjarjet bashkëkohëse në Perandorinë Osmane. Të fuqishëm, të ashpër dhe asgjësues për politikën e kundërshtarit janë artikujt-pamflet mbi intrigat greke e sllave në Rumeli; polemikat me gazetën greke “Neologos”, kundër politikës austro-hungareze; polemikat me gazetën serbe “Istok” dhe “Die Presse” të Vjenës, për politikën grekomadhe në Europë.<sup>4</sup>

Në këtë gazetë, S. Frashëri lëvroi me sukses edhe llojet e tjera të gazetarisë. Është mjeshtër i artikullit-pamflet. Kjo vihet re në shkrimet me tematikë politike, filozofike, ideologjike e shoqërore. Në artikullin kushtuar Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Samiu përpunoi idetë progresive mbi të drejtat e kombit shqiptar dhe kufijtë e Shqipërisë.<sup>5</sup> Në mjaft artikuj të “Terçuman-i Sark”, në mënyrë të programuar e sistematike publikoheshin të dhëna e fakte historike e shkencore kundër pikëpamjeve e manipulimeve sllave e greke se, gjoja, Lidhja e Prizrenit ishte një instrument fetar islamik. Studiuesi britanik Noel Malcom, në librin e tij “Bosnja, a short history”, nuk përmend asnjë përpjekje të shqiptarëve për t’u implikuar në mbrojtje të vilajetit të Bosnjës në emër të motiveve fetare apo të luajalitetit perandorak. “E nëse ka ekzistuar një “simbiozë e ngushtë”, ajo është thjesht politike dhe aspak fetare – shkruan Malcom.”<sup>6</sup> Ndërsa fletorja franceze “Journal de Debat”, duke shkruar për Lidhjen e Prizrenit, qartëson: “Ndërmjet kryengritjes boshnjake dhe asaj shqiptare ka një ndryshim: boshnjakët janë nxitur kryesisht nga fanatizmi fetar; kurse shqiptarët janë të veshur nga ndjenja e kombësisë dhe sedra kombëtare pa kurrfarë fanatizmi fetar”.<sup>7</sup>

Për t’ua bërë të ditur lexuesve dhe qarqeve zyrtare përmbajtjen dhe misionin e kuvendit shqiptar të Prizrenit, Samiu publikoi programin prej 7 pikash. Disa prej tyre janë: “1. Të ruhet e drejta e sovranitetit të personit, të madhësisë dhe të mos u jepet nga toka e Shqipërisë asnjë pëllëmbë tokë popujve tanë fqinj”; 2. Kërkojmë “të drejtat e një Vilajeti autonom me

4 - Shih edhe revistën “Tribuna e gazetarit”, Tiranë, 31 korrik 1978

5 - Gazeta “Terçuman-i Sark”, nr. 87, 23 korrik 1878

6 - Gazeta “Terçuman-i Sark”, nr. 109, 4 gusht 1878

7 - Gazeta “Terçuman-i Sark”, nr. 133, 29 gusht 1878

emrin “Vilajeti i Shqipërisë” që të përmbledhë tre vilajete: të Kosovës, të Shkodrës dhe të Janinës”;...” 3. Pa marrë parasysh dallimet fetare dhe klasore, të zgjidhen në mënyrë të barabartë këshillat e nahijeve nga popullsia e tyre; nga këto këshilla, po në atë mënyrë, të zgjidhen këshillat e kazave dhe, po ashtu, nga këshillat e kazave të zgjidhen këshillat e sanxhakëve, dhe nga këto, Këshilli i madh i Vilajetit”.<sup>8</sup> Kohë pas kohe, në editoriale a shkrime kushtuar Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, vihej theksi në domosdoshmërinë e ruajtjes së territoreve shqiptare, sidomos të trojeve etnike, duke shpjeguar se thelbi i programit të Lidhjes ishte: “... të shpëtonte nga copëtimi, tërësinë territoriale të Shqipërisë dhe të përmirësonte gjendjen e saj të brendshme me anën e “reformave” të përshtatshme për vendin”.<sup>9</sup>

Në artikuj të veçantë, Samiu, me vetëdijen e tij të lartë kombëtare, gjente rastin për të nxjerrë në pah rolin armiqësor edhe të Fuqive të Mëdha që, për interesa e koniunktura politike, sakrifikonin trojet shqiptare dhe Shqipërinë. Duke bërë fjalë për përpjekjet e Ruisë për pansllavizmin ballkanik e më tej, “Tercuman-i Sark” shkruante: “Synimin e Ruisë e tregoi Traktati i Shën Stefanit... ajo i dha Bullgarisë trojet e Shqipërisë, që një ditë të dalë në Adriatik” ...Dhe ia zbulonte “petët e lakrorit” Traktatit, që pjesët e Shqipërisë veriore, “...pra, Prishtinën, Prizrenin dhe Shkodrën, ua dhuronte Serbisë e Malit të Zi; ndërsa krahinat jugore, domethënë Sanxhakët Prevezë, Janinë dhe Gjirokastrë t’i jepeshin Greqisë, duke e zhdukur Shqipërinë, madje duke e fshirë atë nga harta”.<sup>10</sup>

Në një kohë që drejtonte gazetën “Tercuman-i Sark”, Samiu botonte artikuj të thuktë për çështjen shqiptare edhe në të përkohshmen prestigjioze të asaj kohe në Stamboll, “Tercuman-i hakikat”. Opinioni intelektual i kryeqytetit të Turqisë vlerësoi ciklin e shkrimeve, artikuj e pamflete politike, publikuar në numrat 50, 159, 167 e 168 të kësaj gazete. Përmes tyre, i përcilleshin opinionit publik informacione, mendime dhe interpretime të reja e të qarta për Shqipërinë dhe shqiptarët. Me atë ton, nivel

8 - Gazeta “Terçuman-i Sark”, nr. 148, 15 shtator 1878

9 - Gazeta “Terçuman-i Sark”, 24 dhjetor 1878

10 - Gazeta “Terçuman-i Sark”, 3 janar 1879

e saktësi “për herë të parë u paraqiten kërkesat shqiptare për pavarësi përpara opinionit turk, çka shkaktoi polemika të mëdha”.<sup>11</sup> Po ashtu, krahas drejtimit të gazetave e revistave të caktuara, bashkëpunoi me gazeta të tjera të Stambollit, si “Teran-i hakikat”, njëra prej periodikeve më të njohura të kohës etj., për të përhapur e propaganduar idetë e tij përparimtare, për të mbrojtur të drejtat e kombit shqiptar.

Politika shqiptare e të përditshmes “Terçuman-i Shark” dhe jehona e saj edhe tej kufijve të Turqisë u bënë shkas që botuesit, nën trysinë e administratës së Stambollit, ta largonin Samiun nga drejtimi i gazetës. Por ai nuk e ndërpreu veprimtarinë publicistike. Pas një kohe, në vitin 1881, themeloi revistën “Haifa” (Java). Në të 20 numrat e asaj të së përkohshmeje, ai i përçoi audiencës ide, mendime dhe mësimë për jetën, kulturën dhe qytetërimin. Në ato kohë e rrethana, Sami Frashëri, më 20 shkurt 1881, i shkruante Jeronim de Radës: “Punët që po bën Lidhja e Shqipërisë në Gegëri që prej një muaji e tëhu mbase nuk i kini dëgjuar, sepse gazetat e Evropës nuk bëjnë shumë fjalë për to, meqenëse, nga njëra anë, Turqia nuk lë që ato të përhapen nëpër botë, nga ana tjetër, armiqtë tanë, grekë dhe sllavë, duan t’i tregojnë sikur janë të vogla dhe të pakta”.<sup>12</sup>

Akademiku Zija Xholi argumentonte mendimin se, e drejtuar nga Sami Frashëri, fletorja “Përkthyesi i Lindjes” i dha shumë vend çështjes shqiptare, sa mund të konsiderohet si mbrojtësja më konsekuente e Lidhjes së Prizrenit dhe e qëndresës së saj;<sup>13</sup> ide misionare të “Komitetit Qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare”.<sup>14</sup>

Samiu, edhe me atributet e kryetarit të “Shoqërisë së të

11 - Revista “Gjurmime Albanologjike” - Seria Shkencat historike, Prishtinë, 1968, nr. 1., fq.109

12 - Izmi Zeka - <http://lajme.dervina.com/>, e enjte, 8 korrik 2010; 17:37

13 - Profesor Zija Xholi - “Sami Frashëri”-Tiranë. 1978, fq. 19

14 - Ky komitet i njohur edhe si Komiteti i Stambollit “frymëzues dhe organizues i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, u formua në Stamboll, në dhjetor të vitit 1887. Kryesohej nga Abdyl Frashëri dhe përbëhej nga Sami Frashëri, Pashko Vasa, Jani Vreto, Zija Prishtina, Ahmer Koronica, Mihal Harito, Iljaz Qoku, Mehmet Ali Vrioni, Seid Seremedin Toptani etj.” - Shih - Fjalor enciklopedik shqiptar - Tiranë, 1985, fq. 501.

shtypurit shkronja shqip”,<sup>15</sup> merrej me botime librash shqip, por edhe me publicistikë. Në vitet 1884-1885 ai drejton të parën revistë didaktiko-pedagogjike shqiptare ““Drita”- “Dituria”” (“Skronjmësime e përherçme”),<sup>16</sup> ku botoi një varg shkrimesh didaktiko-pedagogjike me vlerë historike edhe për ditët tona.

3. Samiu ishte një nga publicistët më të shquar të periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare, që diti të depërtojë në gazetat e revistat e huaja për të ngritur, pasqyruar e propaganduar çështjen shqiptare, duke mbrojtur të drejtat e kombit dhe të Shqipërisë në tërësi. Autoriteti i tij, si një nga personalitetet e shkencës e të kulturës, ndikoi dukshëm në qarqet gazetareske e publicistike të Stambollit dhe më tej.

Trashëgimia publicistike e Samiut është e madhe. Interesimi për të ka të bëjë me njohjen dhe studimin e proceseve dhe të fenomeneve të zhvillimit të gazetarisë në diasporën shqiptare të afërt e të largët; me rolin e ndikimin e shtypit në të gjithë jetën e shoqërisë, veçanërisht në ato kohë të rëndësishme për kombin shqiptar.

Lënda, shkrimet publicistike të Samiut, me sa kemi arritur të njihemi, tregojnë se ai, edhe kur mori përsipër botimin e gazetave e revistave turke, u prirë nga qëllimi i mirë që të kërkojë e gjejë rrugë e mundësi për të shfaqur e propaganduar Shqipërinë dhe idetë e Rilindjes Kombëtare. Në të 256 numrat e gazetës turke “Sabah”, rrallë gjen numër gazete ku të mos ketë një shkrim të Samiut: artikull apo kryeartikull për problemet politike, filozofike, estetike, kulturore a shoqërore.

Në fletoren “Sabah” (Mëngjesi) Samiu formuloi edhe disa parime të gazetarisë profesionale, duke dhënë ndihmesë teorike dhe praktike edhe për gazetarinë tonë bashkëkohëse. Në editorialin e numrit të parë të gazetës “Sabah” arsyetonte: “Që një gazetë të jetë e dobishme... duhet... E para, të shkruhet me

---

15 - “Shoqëri patriotike kulturore arsimore, themeluar në Stamboll më 12 tetor 1879 me kryetar Sami Frashërin” -Shih -Fjalor enciklopedik shqiptar -Tiranë, 1985, fq. 1028.

16 - Prof. Dr. Nasho Jorgaqi, në artikullin e publikuar online “Detaje nga jeta private e intelektuale e enciklopedistit Sami Frashëri”, shkruan se Samiu ishte “Kryeredaktori i parë i revistës së parë shqipe ““Drita”-“Dituria””. (Redaksia Online d.a. “Shqiptarja.com”, 18 maj 2014, 7:20.

gjuhë që ta kuptojmë të gjithë, shkurt; e dyta...të shitet me çmim të lirë, që secili të mund ta blejë...”<sup>17</sup>

Për historinë e gazetarisë shqiptare, interes të veçantë paraqet traktati “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet”, botuar më 1899 në gazetën shqiptare “Drita” të Bukureshtit (Rumani); traktat - manifest i Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Në të, në zbatim të programit, të lëvizjes kombëtare, të strategjisë dhe taktikës së përcaktuar në Kuvendin e Prizrenit, përvijoheshin idealet kombëtare e demokratike të zhvillimit politik e shoqëror; dritësohej ardhmëria e arsimit, e kulturës dhe e shkencës në “Vilajetin shqiptar”. Karakteri shkencor publicistik i këtij traktati historik, politik e filozofik nuk shihet vetëm në faktin se ai u botua në një gazetë, por në tërësinë e konceptimit dhe të ndërtimit, në mënyrën e trajtimit të problemeve politiko-shoqërore bashkëkohëse, parë në perspektivë; në praninë e fakteve e argumenteve të realitetit konkret; në interpretimet, komentet dhe qëndrimet e drejtpërdrejta të autorit rreth tyre; në frymën dhe stilin komunikues me audiencë etj.

Në publicistikën e Sami Frashërit bie në sy trajtimi i një vargu problemesh me rëndësi politike e shoqërore për kohën; artikuj, editoriale dhe pamflete mbi fatin e Perandorisë Otomane në tërësi dhe Rumelisë në veçanti; mbi fuqitë europiane dhe të ashtuquajturën çështje të Lindjes, mbi kërcënimin e copëtimit e territorit të Shqipërisë nga qarqet shoviniste të shteteve fqinje (Serbia, Mali i Zi, Bullgaria etj.); mbi fanatizmin fetar e nacional; mbi probleme të reformave të sistemit konstitucional të lirisë, barazisë, të riorganizimit të aparatit shtetëror etj.

\*\*\*

Pas një vështrimi sado të shkurtër të veprimtarisë publicistike të Samiut do të mund të arrinim në tri përfundime: së pari, gazetarja ishte pjesë e tërë qenies së tij shoqërore, kulturore, politike; së dyti, Samiu shfrytëzoi publicistikën për interesa thellësisht kombëtare në momentet më të rëndësishme për Shqipërinë dhe shqiptarët; së treti, ai ishte mjeshër i polemikës me mediat e kohës.